

Kur'an Iv – Syllabus I Përpunuar

Të dhëna bazë

Lënda: KUR'AN IV

Programi i studimit: Studime Islame

Kodi i lëndës: 407

Statusi: Obligative

ECTS: 7

Fondi i orëve: 6+2

Semestri: VIII

Viti akademik: 2025/2026

Mësimdhënësi: Dr. Hfz. Safet Hoxha

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i lëndës është t'i njohë studentët me specifikat e formës përfundimtare të mushafëve të kodifikuar sipas Othmanit r.a., si: vokalizimi, pikësimi, ndarja dhe numërimi i ajeteve sipas shkollave të ndryshme. Po ashtu, studenti fiton njohuri rreth dispozitave që lidhen me leximin e Kur'anit, si dhe rregullave të prekjes, bartjes dhe respektimit të mushafit.

Rezultatet e pritura të nxënies

Në përfundim të lëndës studenti:

- Zbaton rregullat e përgjithshme të leximit dhe sjelljes me mushafin.
- Njeh zhvillimin historik dhe format përfundimtare të shkrimit të mushafit.
- Dallon leximet dhe mekamin sipas rivajeteve.
- Zbaton etikën islame të leximit të Kur'anit, të mbështetur në Kur'an dhe Sunet.

Metodologjia e mësimdhënies

Ligjërata teorike, lexim praktik (muxheved), dëgjim profesional, ushtrime individuale dhe grupore, seminare.

Programi javor i lëndës

Java 1

Shenjëzimi dhe vokalizimi i Kur'anit. Definimi i dabt, shekl dhe nukat. Shkaqet dhe iniciatorët e vokalizimit dhe pikësimit. **Literatura:** Resmul Mushaf, fq. 87–89

Java 2

Pjesëzimi i mushafit në xhuza dhe hizbe. Rregullat përfundimtare të shkrimit. Shenjat grafike (sukun, tenvin, elif/vav/ja i vogël). **Literatura:** Po aty, fq. 90–103

Java 3

Veçoritë e leximit të Hafsit: sekte, imale, teshil, ishman, nakël. Shkenca e numërimit të ajeteve.

Literatura: Resmul Mushaf; Sherh Nadhimetu'z-Zuhr, fq. 14–19

Java 4

El-Fasile (fundi i ajetit). Shkollat e numërimit të ajeteve. Etika e bartësit të Kur'anit. **Literatura:** Sherh Nadhimetu'z-Zuhr, fq. 11–45

Java 5

Pagesa për mësim të Kur'anit. Programet e hatmes dhe harresa e Kur'anit. **Literatura:** Et-Tibjan, fq. 50–63

Java 6

Çfarë preferohet dhe çfarë urrehet para dhe gjatë leximit të Kur'anit. **Literatura:** Et-Tibjan, fq. 69–76, 93–94

Java 7

Format e leximit: përmendësh, pamor, grupor. Zbukurimi i zërit. **Literatura:** Et-Tibjan, fq. 95–114

Java 8

Ezan, ikamet, tekbire dhe leximi sipas mekameve. **Literatura:** Hakku't-Tilave; Fenu't-Tertil

Java 9

Gjendjet kur nuk preferohet leximi. Risi në lexim. **Literatura:** Et-Tibjan, fq. 116–123

Java 10

Leximi në namaz dhe sexhdeja e tilavetit. **Literatura:** Et-Tibjan, fq. 126–145

Java 11

Sjellja e përgjithshme ndaj Kur'anit dhe dispozita të ndryshme. **Literatura:** Et-Tibjan, fq. 163–185

Java 12

Ajetet dhe suret e preferuara sipas kohës dhe gjendjes. Nderimi i mushafit.

Java 13

Dispozitat e prekjës, bartjes dhe shitblerjes së mushafit. **Literatura:** Et-Tibjan, fq. 186–197

Java 14

Metodat e hifzit dhe praktikat në botën islame dhe trojet shqiptare. **Literatura:** Delilu'l-Hajran; Ahlaku Hameleti'l-Kur'an

Java 15

Hafizët dhe kurratë më të njohur. Përmbyllje e lëndës.

Vlerësimi

- Pjesëmarrja dhe aktiviteti: 10%
- Punimi seminarik: 30%
- Provimi final: 60%

Literatura obliguese

1. En-Nevevi, *Et-Tibjan fi Hameleti'l-Kur'an*
2. Abdul Fetah el-Kadi, *Sherh Nadhimetu'z-Zuhr*
3. Husni esh-Shejh Othman, *Hakku't-Tilave*
4. Ibrahim Terbinjac, *Studimi dhe këndimi i Kur'anit*

Literatura jo obliguese

Es-Sujuti, Ez-Zerkeshi, Ez-Zerkani, Ejmen Suvejd, etj.

Politikat akademike

Vijimi i rregullt i ligjëratave, respektimi i rregullave të mirësjelljes akademike dhe disiplinës në mësim.

Ngarkesa e studentit

Totali: **132 orë** (në përputhje me 7 ECTS).